STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 16 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON se të çarat në Ishujt e Pengesës në Long Ajlend (Long Island) të shkaktuar nga Uragani Sendi (Sandy) do të mbyllen duke filluar të hënën

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se puna do të fillojë të hënën për të mbyllur të çarat në Ishujt e Pengesës të Long Ajlënd (Long Island) të shkaktuara nga Uragani Sendi (Sandy). Shteti nënshkroi kontrata me Korpusin e Inxhinierëve të Ushtrisë së SHBA-së, të cilët pajtuan kontraktorë për të filluar punë menjëherë në Smith Point County Park dhe Cupsogue County Park në Qarkun Safolk (Suffolk).

"Uragani Sendi (Sandy) shkaktoi dëmtim të rëndë në plazhet e pengesës të Long Ajlënd," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Me ndihmën e Korpusit të Ushtrisë, mund të fillojmë riparimet në ato të çara disa javë pasi goditi Uragani Sendi (Sandy). Mbyllja e këtyre të çarave shpejt do të parandalojë që ato të thellohen, të zgjerohen dhe të bëhen më të vështira e më të shtrenjta për t'u riparuar."

Të çarat janë në anët lindore e perëndimore të Gjirin Morikes (Moriches). Korpusi arriti në përfundimin se mbyllja e të çarave është e nevojshme dhe do të punojë për mbylljen menjëherë. Shteti i Nju Jorkut do të paguajë sasinë e tij të pjesës jo-federale të kostove të projektit nëpërmjet programit Punët e Nju Jorkut.

Përveç kësaj, Qarku Safolk (Suffolk) nënshkroi kontrata me Shtetin për të qënë financuesi vendor për këto mbyllje. Që në 30 tetor, Departamenti i Shtetit për Mbrojtjen Mjedisore dhe partnerët e tij vendorë e federalë kanë dokumentuar dëmin e stuhisë në bregdetin e Long Ajlënd (Long Island). Nëpërmjet këtyre vlerësimeve, tre të çara janë identifikuar deri më tani:

- E çara e Smith Point County Park është rreth 50 jarde e gjerë dhe gjendet rreth 5,000 metra në perëndim të kepit perëndimor të Gjirit Morikes.
- E çara e Cupsogue County Park pak në lindje të kepit lindor të Gjirit Morikes (Moriches) dhe është rreth 1,000 këmbë e gjerë.
- E çara e tretë është në Zonën e Shkretë të Bregdetit të Ishullit Kombëtar të Zjarrit. Shërbimi i Parkut Kombëtar është duke zhvilluar vlerësime të mëtejshme të të çarës përpara sesa të përcaktojë nëse duhet të mbyllet.

Albanian

Një Plan i Ngjarjeve të Paparashikuara të të Çarave u krijua pas të çarës në Uesthemptën (Westhampton) të viteve 1990-të për të përshpejtuar mbylljen e të çarave dhe për të mbrojtur komunitetet dhe infrastrukturën e gjirit, si dhe për të pakësuar kostot. Nëpërmjet zbatimit të Planit të Ngjarjeve të Paparashikuara të të Çarave dhe marrëdhënieve të punës të krijuara mirë të agjencive të qarkut, shtetit dhe federale, të çarat e Cupsogue dhe Smith Point do të mbyllen në një periudhë kohore jashtëzakonisht të shpejtë.

Sipas marrëveshjes së ndarjes së kostos në Planin e Ngjarjeve të Paparashikuara të të Çarave, qeveria federale do të paguajë për 65 përqind të kostos për të mbyllur të çarat dhe 35 përqind e mbetur do të paguhet nga Shteti dhe Qarku Safolk (Suffolk).

“Korpusi i Inxhinierave i Ushtrisë është i gëzuar që do të jetë në gjendje të punojë me partnerët tanë në Departamentin e Ruajtjes Mjedisore të Shtetit të Nju Jorkut për të mbyllur shpejt dhe me siguri të çarat e shkaktuara nga Uragani Sendi (Sandy),” tha Komandanti i Distriktit të Nju Jorkut Kol. Poll E. Ouen. “Me planifikimin me përparësi të bërë nëpërmjet Planit të Ngjarjeve të Paparashikuara të të Çarave, mezi po presim që t’i mbyllim të çarat shpejt që të riparojmë ishullin e pengesës.”

“Plani i Ngjarjeve të Paparashikuara të të Çarave parashikon hapat e nevojshme për të rindërtuar pjesët e çara të Long Ajlënd (Long Island),” tha Komisioneri i DEC-ës Xho Martens. “Një e çarë e ishullit të pengesës mund të rezultojë në batica më të larta dhe vërshime të stuhisë për komunitetet anës gjirit, gjë që do t’i ekspozojë ndaj rrezikut në rritje të përmbytjes përgjatë sezonit të stuhive të dimrit. Programi Punët e Nju Jorkut dhe partneriteti i fortë i DEC-ës me Korpusin e Ushtrisë, agjencitë e tjera federale dhe Qarkun Safolk (Suffolk) ka lejuar që ky projekt të përshpejtohet, në mënyrë që të mund të fillojmë procesin e rimëkëmbjes për plazhet e Long Ajlënd (Long Island).”

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418